



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Himarë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE AUTOMJETE ZJARRËFIKËSE TË KOMPLETUAR DHE  
AUTOBOT”**

1. KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Automjete zjarrfikëse 34144210-3
2. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **41,290,370** (dyzetë e një milionë e dyqind e nëntëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë) **lekë , pa TVSH, ose 424,711 Katërqind e njëzet e katër mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë.) EURO pa TVSH (me kursin e këmbimit 97.22 të datës 11.08.2025)**
3. **Burimi i financimit:** Buxheti i Bashkisë Himarë miratuar me miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.42 datë 20.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2025”, vlersuar i ligjshëm nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr.1133/1 datë 30.12.2024, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.35 datë 07.01.2025. .
4. **Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës: 2 (dy) Muaj**
5. **Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës: Në ambientet e Autoritetit Kontraktor.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim me përmbajtjen si më poshtë, për procedurën me objekt “**Blerje Automjete Zjarrëfikëse të Kompletuar dhe Autobot**”.

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR:**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:
  - a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
  - b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
  - c. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1*

#### *d. Lista e çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 2*

*Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

#### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2022, 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e përlogaritur e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit/ vlera e pritshme e kontratës së përlogaritur për lot, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

*Pika 2/a ..... dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”. Vlera e përlogaritur është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

**2.2.2** Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2022, 2023, 2024 të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët ekonomike të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e germës “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009” Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, germa “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

**2.2.3.** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal për shlyerjen e taksave vendore (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; ne të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

\*\*\* Kriteri 2.2.3 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, germa d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të

*Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi në përputhje me dispozitat ligjore.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1.** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me certifikatën për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001: 2015 ose ekuivalente me të. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt marrëveshjes së bashkëpunimit.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë

kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

- Standardi ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmëria e burimeve të tij, kompetenca/profesionalizmi i punonjësve, procesi i menaxhimit (për furnizim, ofrim shërbimesh dhe për proceset mbështetëse e administrative), planifikimi i cilësisë, garantimi i një procesi cilësor të furnizimit, sigurimi i konformitetit për shërbimet, proceset e tij për

të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për standardin ISO 9001 ose ekuivalent me të, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës në të gjithë komponentët e saj.

**2.4.2.** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë licencë të vlefshme lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Kategoria VII.3.B, sipas Udhëzimit Nr. 1546 datë 29.03.2016, “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”, ose licencë ekuivalente sipas legjislacionit në fuqi të vendit ku operatori ekonomik ofertues ka selinë, në rastin e operatorëve ekonomike të huaj.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) neni 40 pika 5/a, i cili përcakton se:

[Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose ]

Kjo licensë është kërkuar duke marrë shkas nga llojet e mallrave që do të ofrohen/ blihen nga AK dhe konform VKM Nr 538 dt 26.05.2009 për “Licencat edhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullimi të tjera nënligjore të përbashkëta” (e ndryshuar). Kjo lloj license si më poshtë vijon ndër të cilat përfshihet edhe kërkesa objekt prokurimi:

"Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove", me kodin VII.3.B.1, ku përfshihen:

a) riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

b) riparimi dhe mirëmbajtja e karrocërës së mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

c) riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

ç) riparimi dhe mirëmbajtja e gomave të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

d) blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkiove;

dh) mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura.

....Vërteton ekzistencën dhe përshtatshmërinë e OE lidhur me tregtimin/ shitjen e mjeteve me motor dhe rimorkiove.

Kërkesa e DST, pika 2.4.6 “Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë që disponon Licencë për ushtrimin e veprimtarisë, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1/d “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”, është në përputhje dhe në proporcion me nevojat dhe aktivitetet e kontratës si dhe me qëllimin final të kësaj kontrate, pasi licenca VII.3.B.1, **Pika d. i referohet pikërisht** “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio;”.

**Kërkesa e mësipërme bazohet në:** Ligji nr. 9573, datë 03.07.2006, “për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to” -VKM Nr. 107, datë 10.02.2016, Për një shtesë në VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar. -Udhëzim Nr. 1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi I mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”



**2.4.3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar për mallrat e kërkuara. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/ Distributorit të Autorizuar si telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet e dokumentuar lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit për mjetet e ofruara.

*Shënim: Autorizimi duhet të paraqitet në gjuhën/gjuhët e përcaktuar në DST.*

**Argumentimi:** Referuar nenit 77, pika 1 dhe 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Si dhe pika 4, [...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.]

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”

Duke qenë se Autoriteti kontraktor, është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për furnizimet e kryera, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Në këtë kontekst, referuar natyrës, volumit dhe objektit të prokurimit, kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, shërben si garanci në çfarëdo rasti anomalie të mundshme përgjatë afatit të ekzekutimit të kontratës, si dhe garanton aktivizimin e shërbimeve të prodhuesit, sic janë ato të suportit dhe mbështetjes teknike e administrative.

Kjo kërkesë jep garanci më tepër për:

- Përfshirjen dhe suportin e prodhuesit, përmes rishitësit/partnerit të autorizuar.
- Vazhdimësinë dhe jetëgjatësinë e produktit
- Përmes regjistrimit të të dhënave të prodhuesit, përfitim të mëvonshëm potencial të suportit nga ana e tyre.

Gjithashtu, ky dokument siguron AK se:

1- Operatori ekonomik ka leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në tregun e Shqipërisë dhe se janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto mjete.

2- Nëpërmjet informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktoje me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

3- Operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mjeteve. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të kërkojë garanci mbi cilësinë e shërbimit dhe llojit të mjetit të ofruar, si dhe përfshirjen e vet shërbimeve dhe

suportit të prodhuesit/ distributorit zyrtar në këtë kontratë.

Referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi/ distributori i autorizuar, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues.

Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë monitoruese të mjeteve të ofertuara dhe nevojës për garanci mbi eficientë dhe kapacitetet teknike të tyre.

Në përfundim, vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është e arsyeshme dhe e nevojshme për garantimin e cilësisë, autorizimit dhe transparencës në kete proces. Kjo është një mënyrë e mirë për të garantuar që furnizimi me mallra të realizohet me sukses dhe pa probleme të panevojshme. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Katalogun ose skedën teknike të prodhuesit ku të tregohen karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, të cilat duhet të përmbushin plotësisht specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik.

**Shënim:** Pjesët/ Fragmentet e Katalogut/ ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë në gjuhën/gjuhët e përcaktuar në DST.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) neni 40 pika 6/b, i cili përcakton se :

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

...b) fotografite apo katalogët teknikë; dhe/ose”...

Katalogu/fragment katalogut i mjeteve tregon te dhenat teknike lidhur me pjeses e kembimit, sikurse jane : lloji i mjetit forma, dimensionit...eti).

Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për pajisjet që propozon/oferton. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

Së pari, paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth mjeteve. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë e mjeteve që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.

Së dyti, kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mjetet e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.

Së treti, kriteri lidhur me “Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë në gjuhën/gjuhët e përcaktuar në DST. “, është vendosur pasi, Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës, pra shqip apo anglisht. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim (shqip apo anglisht).

**2.4.4.** Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë garancie për mallrat e ofertuara, në të cilën të jenë të përcaktuara dhe përshkruara qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi. Periudha e garancisë teknike të fillojë nga data e marrjes në dorëzim të mallrave nga autoriteti kontraktor dhe të jete:

- |                      |             |
|----------------------|-------------|
| • Kamion zjarrfikëse | 1 (një) vit |
| • Autobot Uji        | 1 (një) vit |

**2.4.5.** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e mjeteve, gjate periudhës së garancisë.

**2.4.6.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se me dorëzimin e mjeteve objekt i procedurës së prokurimit, (për ato mjete që aplikohet), detyrimisht do të mbulojë me shpenzimet e tij të gjitha pagesat në lidhje me:

- Tarifën e kontrollit fizik
- Tarifën e regjistrimit (targat)
- Pagesën për kontrollin teknik (në rastet kur nuk përjashtohet nga DPSHTRR)
- Pagesat për TPL

**Argumentimi (2.4.5/6/7):** Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe të mbulohen demtimet brenda periudhës së garancisë. Kriteri i kërkuar në lidhje me deklaratën, është vendosur në përputhje me pikën 8, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

**Shënim:** 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik”, I ndryshuar, “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur



3. “Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.”

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):**

*Termat e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën me objekt “**Blerje Automjete Zjarrfikëse**”, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

### **Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); VKB-së nr. 125 datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Himare për vitin 2024”; grupi i punës hartoi specifikimet teknike për realizimin e objektit: “**BLERJE AUTOMJETE ZJARRËFIKËSE TË KOMPLETUAR DHE AUTOBOT**”, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Bazuar në specifikimet teknike të miratuara dhe hartuara nga struktura e ngarkuar për këtë qëllim, Grupi i punës vendosi të bëjë studimin e tregut për çmimin e për automjet zjarrfikës, mbi bazën e të cilës përcaktohet fondi limit për procedurën e prokurimit. Pas identifikimit të subjekteve që operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet, kërkesa për përllogaritjen e fondit limit me qëllim llogaritjen e vlerës së kontratës, ju dërgua 3 subjekteve, në përputhje me kërkesat teknike të përgatitura nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Himare “Për krijimin e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën “**BLERJE AUTOMJETE ZJARRËFIKËSE TË KOMPLETUAR DHE AUTOBOT**”.

Nevoja për mjete zjarrfikëse bazuar edhe në buxhetin në dispozicion, është parashikuar për 3 Automjete/kamion zjarrfikës 4x2

Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur urdhër të Titullarit të AK Bashkia Tiranë, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave për mjete zjarrfikëse që kanë strukturat e MZSH-së, përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e investimit.

### **Specifikimet teknike**

Termat e referencës dhe kërkesat funksionale/ specifikimet teknike hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM

nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(I ndryshuar), për përmbushjen e qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

Qëllimi i këtij investimi është kompletimi i stacioneve zjarrëfikëse të cilat kanë nevojë të shtohen dhe të përmirësohen me automjete dhe teknikë bashkëkohore, paisje e materiale zjarrfikëse, në shërbim të komunitetit për përballimin e situatave të zjarrit, emergjencave të ndryshme, eliminimin e pasojave të përmbytjeve dhe rasteve me rrezik të shtuar.

## **NJESIA E PROKURIMIT**

**Orest Vela**

**Uran Dulaj**

**Astrit Lloi**